

Ne perputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723/2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ky dokument perben:

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI

I

SHOQERISE

"AA PARTNERS" SH.P.K.

TIRANE / SHQIPERI

KAPITULLI

Data e Themelimit, Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

Neni 1. Data e Themelimit dhe Emri

1. Me efekt nga data 11/07/2023 themelohet shoqeria "AA PARTNERS" (ne vijim "Shoqeria"), e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk", cili perfaqeson formen ligjore te saj, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.
2. Ortaket e Shoqerise ("Ortaket") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuota.
3. Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga:
 - (i) fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk";
 - (ii) numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj;
 - (iii) adresa e regjistruar, dhe
 - (iv) dhe pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.
 - (v) Kapitalin e regjistruar te Shoqerise dhe kapitalin e paguar te Shoqerise.

Neni 2. Forma dhe Baza Ligjore

- 2.1. Shoqeria do te zhvilloje veprmtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e dt 11/07/2023 te nenshkruar ndermjet Ortakeve te Shoqerise, si dhe legjislacionin shqiptar.
- 2.2 Shoqeria eshte nje entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("shoqeri me pergjegjesi te kufizuar"), ne perputhje me ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ("Ligji i Shoqerive").

Neni 3. Selia

- 3.1. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga e Kavajes, Ndertesa Sun Tower, Kati I-re, Kodi Postar 1000, Njesia Bashkiake nr. 10, Tirane, Shqiperi. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjetër te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 4. Kohezgjatja

- 4.1. Veprimtaria e Shoqerise fillon pas regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.
- 4.2 Kohezgjatja e Shoqerise do te jete per afat te pacaktuar.

KAPITULLI II

Neni 5. Objekti i Shoqerise

- 5.1. Objekti aktivitetit te Shoqerise do te jete;
- 5.1.1. Aktivitete inxhnierike dhe konsulenca teknike te lidhura me to
- 5.1.2. Të tjera punime të specializuara ndërtimi

Neni 6. Ndryshime

- 6.1. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut duke marre parasysh dispozitat e ligjit Shqiptar

KAPITULLI III

Kapitali Themeltar: Quotat e Kapitalit Themeltar

Neni 7. Kapitali Themeltar

1. Kapitali i themeltar Shoqerise eshte shuma e barazvlefshme ne Leke e vleres **5,000.00 EUR** (pese mije euro), plotesisht te nenshkruara dhe te pashlyera.
2. Kapitali i Shoqerise do te shlyhet nga Ortaket, ne proporcion me pjeset e tyre takuese, brenda nje periudhe prej 1 viti nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKB.
3. Kapitali i Shoqerise do te perbehet nga 1 (nje) Kuote.

Neni 8. Ortakët e Shoqerisë dhe Kuotat

1. Ortakët e Shoqerisë dhe kuotat e zotëruar prej tyre në Shoqëri janë si më poshtë:

- (i) **Avni Ahmeti** shtetase kosovare i lindur më 22.03.1987 në Kosovë, me nr. personal 1172733448 dhe nr. Pasaportës P01682053 që zotëron një kuotë që përfaqëson 100 % të kapitalit të Shoqerisë, në shumën e barazvlefshme në Leke e vlerës **5,000.00 Euro**

Neni 9. Zvogëlimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

1. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit të Shoqërive.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave (nëse ka) dhe fitimit.
3. Rritja e kapitalit do të bëhet me kuota të reja apo me rritjen e vlerës së kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit themeltar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre nominale do të paguhet plotësisht.
4. Zmadhimi i kapitalit nuk do të dobësojë pjesët e interesit të Ortakëve në Kapitalin e Shoqerisë, përveçse kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, vendim i cili do të merret me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ e votave.
5. Shoqëria nuk mund të blejë asnjë kuotë të saj. Megjithatë, me qëllim zvogëlimin e kapitalit të Shoqerisë, nëpërmjet vendimit për zvogëlimin e kapitalit, Ortakët mund të autorizojnë Administratorin/Administratoret të bëjnë blerjen e kuotave përkatëse apo pjesë të tyre dhe t'i anulojnë ato.

Neni 10. Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

1. Ortakët janë vetëm ata të cilët zotërojnë kuotat e Shoqerisë.
2. Çdo Ortak do të ketë të drejtë vote në Asamblesë të Përgjithshme të Ortakëve ("**Asambleja e Përgjithshme**") në përputhje me vlerën nominale të kuotës që zotëron. Çdo Ortak ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqerisë, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos të shpërndajë fitimet, sikundër të drejtat e parashikuara nga ky Statut, për çdo marrëveshje të detyrueshme ndërmjet Ortakëve dhe dispozitave ligjore të Ligjit të Shoqërive.
3. Ortakëve do t'u jepen, me kërkesë me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqerisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojnë dokumentat dhe raportet e Shoqerisë.
4. Detyrimet e Shoqerisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortakët mundet vetëm të mbajnë përgjegjësi brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë. Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi që tejkalojnë investimin e tyre përkatës në kapitalin e Shoqerisë (përveç garancive dhe huave që ata realizojnë).

Neni 11. Transferimi i pjesëve të Kapitalit

1. Çdo transferim i kuotave apo pjesëve të tyre do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqërive, si dhe të duhet të regjistrohet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.
- 2.

KREU IV
Asambleja e Pergjithshme

Neni 12. Kompetencat

12.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtues i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

Neni 13. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

1. Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.
2. Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
3. Asambleja e Pergjithshme thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjitha aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja e Pergjithshme do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t'i paraqitet Asamblese, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
4. Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga nje Ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
5. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asamblese se Pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
6. Ortaket do te organizojne takime me Administratoret te pakten nje here ne vit me qellim vleresimin e veprimeve te kryera nga Administratoret, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e tyre, perfshire ceshtje per te cilat Administratoret nuk bien dakord.
7. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

Neni 14. Menyra e Thirrjes se Mbledhjeve

1. Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara saj nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.
2. Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga cdonjeri prej Ortakeve.
3. Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjitha Ortaket bien dakort.

4. Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetër ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.
5. Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Vendimi i propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshtetes do t'u dergohet Ortakeve me poste, korrier, telecopy ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaku(et) do te marrin vendim per rezoluten perkatese brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe ju eshte dorezuar rezoluta. Ortaku(et) miratojne rezoluten duke i kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te rezolutes me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me rezoluten shprehin me shkrim kundershite e tyre ne lidhje me rezoluten dhe i'a kthejne ate Administratorit(eve) te Shoqerise. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nese aprovohet me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres.
6. Secili prej Ortakeve ka te drejten te votoje ne perputhje me kuoten e zoteruar prej tij ne kapital.
7. Vendimet e meposhtme do te miratohen me miratimin e Ortakeve qe zoterojne te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise:
 - (i) Pagesa e cdo dividenti ne kesh apo natyre Ortakeve te Shoqerise;
 - (ii) Nenshkrimi i marreveshjeve financiare ne lidhje me Shoqerine apo nxjerrja e instrumentave te borxhit nga Shoqeria;
 - (iii) Blerja e cfaredolloj kuote apo interesi tjerter ne cdo biznes dhe siper marrje;
 - (iv) Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise sic eshte percaktuar ne Nenin 7 te kesaj Marreveshje;
 - (v) Ndryshime dhe amendime te ketij Akti Themelimi; dhe
 - (vi) Likuidimi apo shperndarja e Shoqerise.
8. Atehere kur ligji e kerkon kete, vendimet e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter publik Shqiptar. Ne rast se keto vendime miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen procedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).
9. Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.
10. Administratoret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 15 Perjashtimi nga e drejta e votes

1. Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:
 - (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
 - (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
 - (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
 - (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

KREU V
Administratoret

A. A.

Neni 16. Bordi i Administratoreve dhe kompetencat

16.1 Shoqeria drejtohet nga Administratoret. Administratoret mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezidente ne Shqiperi.

16.2 Administrator i Shoqerise eshte:

- **Edona Sheqerolli** shtetase kosovare e lindur me 16/06/1988 ne Kosove me nr. personal 1171246624 dhe nr. Pasaportes P00896581

16.3 Kohezgjatja e funksionit te Administratorit(eve) eshte per nje periudhe prej 5 vjetesh, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi prane Qendres Kombetare te Biznesit), me te drejte ripertesitje te ketij mandati.

16.4 Menjehere pas pranimit te emerimit te tyre, Administratori(et) njohin se marredhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje vendimi te Asamblese se Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.

16.5 Ortaket kane te drejten te shkarkojne Adminsitratoret me shumice te thjeshte votash.

16.6 Administratori(et) duhet te informoje Ortaket per cdo veprim dhe te marre paraprakisht miratimin e tyre per cdo veprim qe ndermerret ne cilesine e administratorit.

16.7 Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria u rimbursos Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Adminsitratoret(eve) ne vende qe nuk jane brenda qytetit te residences se Administratorit(eve), me kusht qe shpenzimet te jene te justifikuara dhe te kene qene te miratuara paraprakisht.

Neni 17 Kompetencat dhe detyrimet

1. Kompetencat e Administratoreve (secili individualisht) ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

(i) Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet e specifikuara ne nenin 13.

(ii) Menaxhimin e aktivitetit tregtar te shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.

(iii) Perfaqesimin e Shoqerise.

(iv) Kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise.

(v) Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblese se Pergjithshme.

(vi) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit, kur eshte e nevojshme.

(vii) Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise.

(viii) Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

2. Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.

Neni 18 Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia

1. Pavec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 16, 17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, Administratoret detyrohen:
 - (i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;
 - (ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
 - (iii) te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
 - (iv) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;
 - (v) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem
2. Administratoret gjate kryerjes se detyrave te tyre pergjigjen kundrejt shoqerise per cdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.
3. Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.
4. Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqoftese ne kundershtrim me Ligjin e Shoqerive kryen veprimet e meposhtme:
 - (i) i kthen Ortakeve kontributet;
 - (ii) i paguan Ortakeve interesa apo dividende;
 - (iii) i shperndan asetet Shoqerise;
 - (iv) lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitein e saj, kur duhet ta kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj;
 - (v) jep hua.

KREU VI

Administrimi Financiar i Shoqerise

Neni 19. Eksperti Kontabel i Autorizuar

- 19.1 Ortaket mund te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar per t'i sherbyer Shoqerise.
- 19.2 Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII
Aktiviteti i Shoqerise

Neni 20. Viti ekonomiko-financiar

20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon ne ditën e 31-të të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar nis ne datën e themelimit të Shoqerise.

Neni 20. Viti ekonomiko-financiar

20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon ne ditën e 31-të të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar nis ne datën e themelimit të Shoqerise.

Neni 21. Mbajtja e Llogarive

21.1 Shoqeria do të mbajë llogarite ne lekë dhe ne monedhe të huaj.

Neni 22. Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit

22.1. Fitimi i Shoqerise përcaktohet ne baze të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme ne përputhje me Statutin, marrëveshjen e Ortakëve dhe me ligjet e zbatueshme.

22.2. Nga fitimet vjetore, do të caktohet një fond rezerve ne përputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar për fondin rezerve të detyrueshem.

22.3. Ne baze të Ligjit për Shoqerite, Shoqeria mund të shpërndajë fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shpërndarje:

(i) asetet e Shoqerise mbulojnë teresisht detyrimet e kesaj të fundit;

(ii) Shoqeria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që behen të kerkueshme brenda 12 muajve të ardhshem.

22.4. Administratoret leshojne një certifikate të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 22.3 me sipër. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush keto kritere, administratoret nuk mund ta leshojne këte certifikate.

1. Administratoret përgjigjen ndaj Shoqerise për vertetësinë e certifikates së aftësisë paguese.

KREU VIII
Modifikimi i Formes Ligjore: Prishja

Neni 23. Modifikimi i Formes Ligjore

23.1 Forma ligjore e Shoqerise mund të ndryshoje me vendim të Asamblese së Përgjithshme ne përputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

23.2. Shoqeria e re do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit ne Shqipëri.

Neni 24. Prishja e Shoqerise

24.1 Shoqeria mund te prishet ne rrethanat e meposhtme:

- (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- (ii) hapje e nje procedure falimentimi;
- (iii) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (iv) me vendim gjykate;
- (v) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.

24.2 Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njoftimin vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

KREU IX
Te ndryshme

Neni 25. Largimi i Ortakut


25.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga nenet 101, 102, 103 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 26 Te tjera

1. Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

Nenshkrimi i Themeluesve/Ortakeve

Avni Ahmeti



A.A.